



NË PAQE ME NATYRËN

“Earth Day”



Nisma qytetare: Në paqe me Natyrën



Në kuadër të ditës së Tokës, “Earth Day”

Ka ardhur momenti që të ndryshojmë imazhin e vendit tonë, ka ardhur momenti që gjithsecili prej nesh të ndërgjegjësohet në ruajtjen e mjedisit ku jetojmë.

Nisma qytetare “Në paqe me Natyrën” më meshtetjen e Bashkisë së Tiranës ka për qëllim mobilizimin e qytetarëve të Tiranës për ruajtjen, pastrimin, gjelbërimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe hapësirave të gjelbra të qytetit tonë. Nisma do të ketë në fokus një aktivitet që do të organizohet në datën 22 Prill në territorin e parkut të Liqenit ku brenda një dite (22 Prill 2012) synohet mobilizimi i qindra vullnetarëve për pastrimin e mbeturinave dhe riciklimin e tyre, mbjelljen e bimëve të reja në këtë park dhe sensibilizimin e brezave të rinj në lidhje me mbrojtjen dhe pastrimin e natyrës që na rrethon. Kjo ditë synohet të kthehet çdo vit në një traditë të pastrimit të mbeturinave në Tiranë dhe në gjithë Shqipërinë, duke patur si fokus nismen boterore të Ditës së Tokës - “Earth Day”.

Ky aktivitet paraprihet nga një fushatë e madhe sensibilizimi mediatike, do të ketë edhe një pasqyrim të gjerë gjatë ditës së eventit, bazuar në modelin e shumë vendeve të tjera të botës që realizojnë me sukses veprimtari të ngjashme në këtë ditë kushtuar natyrës, por gjithnjë duke marrë parasysh kushtet e vendit tonë dhe nevojat e qytetit ku jetojmë.

Parku i Liqenit, përfaqëson “**mushkëritë e gjelbra**” të Tiranës, ndaj ai është përzgjedhur nga Nisma qytetare “Në paqe me Natyrën” si vendi i pershtatshëm për të filluar me këtë nismë sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese. Qytetarë me familjet e tyre, personazhe të njohur të jetës publike, shoqata dhe organizata jo qeveritare, institucione e biznese që operojnë në qytetin e Tiranës, anetare të të gjitha komuniteteve fetare, janë pjesë e kësaj nisme dhe bashkeveprojne në këtë ditë për të pastruar të gjithë territorin e Parkut të Liqenit.

Objektivi kryesor është ndërgjegjësimi që mbeturinat dhe mjedisi janë përgjegjësi e secilit prej nesh, pra të ndryshohet këndvështrimi për mbeturinat dhe mbrojtjen e mjedisit. Le të veprojmë ne të parët, banorët e këtij qyteti për të krijuar ndryshimin në qytetin tonë.

Ekipi, i cili është duke ndërtuar bazat e kësaj nisme, po punon intensivisht për të realizuar me seriozitet këtë aktivitet. Por asgjë nuk mund të bëhet pa përkrahjen e çdonjërit nga ju dhe partnerëve që duan të na përkrahin në këtë iniciativë. Ne jemi duke kërkuar persona seriozë, institucione, biznese apo individë që të na ndihmojnë të realizojmë diçka që është në të mirë të natyrës dhe qytetit tonë. Do të mjaftonte qofte edhe prezenca e çdokujt prej jush përkrah nesh në datën 22 Prill 2012 për të dhënë mesazhin se ju doni të jeni në paqe me natyrën që na rreth. Më 22 Prill pra, të gjithë së bashku le ta pastrojmë parkun tonë, “Në paqe me Natyrën”.

